

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 138, datë 13.09.2018

PËR

NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR ZBATIMIN E MASAVE 2 DHE 45 TË PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE PËR DIASPORËN

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të vendimit nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe të planit të veprimit".

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për zbatimin e masave 2 dhe 45 të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
2. Grupi ndërinstitucional i punës të përbëhet nga:

-ministri përgjegjës për diasporën	kryetar;
-zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme	anëtar;
-zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për kulturën	anëtar;
-zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për arsimin	anëtar;
-zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për turizmin	anëtar;
-zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për financat	anëtar;
-zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën	anëtar;
-përfaqësues i ministrit përgjegjës për mbrojtjen e sipërmarrjes	anëtar;
-titullari i Agjencisë Kombëtare për Diasporën	anëtar.
3. Ministri përgjegjës për diasporën të përcaktojë Programin Kombëtar Vjetor për aktivitetet e përbashkëta në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë, si dhe të aktiviteve periodike për turizmin shqiptar dhe mundësitë lidhur me investime në Shqipëri.

4. Programi vjetor për aktivitetet e përbashkëta për diasporën (aktivitetet që përfshijnë librin, arsimin, kulturën dhe biznesin) të propozohet dhe miratohet në Komitetin Shtetëror për Diasporën.
5. Ngarkohen Ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe Agjencia Kombëtare për Diasporën për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

